

KARTELE INFORMATIVE

AL105070

1. Emri i shërbimit	Certifikatë ndërkombëtare importi për mallrat ushtarake			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Pajisja me certifikatë për subjektin, i cili kërkon të importojë mallra ushtarake, për të konfirmuar tek Autoritetet e Shtetit Eksportues se ky subjekt do të jetë importues i mallit në Republikën e Shqipërisë			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Pajisjen me certifikatë për subjektin, i cili kërkon të importojë mallra ushtarake, për të konfirmuar tek Autoritetet e Shtetit Eksportues se ky subjekt do të jetë importues i mallit në Republikën e Shqipërisë			
4. A jam përfitues?	Subjektet e regjistruara, personat fizikë, juridikë publikë ose privatë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Deklaratë personale e përdoruesit të fundit mbi përdorimin dhe përdoruesin e fundit	Aplikanti	Po
	2	Dokumente që japin të dhëna për firmën partnere / ndërmjetës (nëse ka) mbi adresën, përfaqësuesin ligjor, si dhe dokumente që vërtetojnë të drejtën e këtyre subjekteve për të kryer transferime ndërkombëtare të mallrave ushtarake	Subjekti i huaj / Aplikanti	Po
	3	Dokumente që japin të dhëna për përshkrimin e mallit, kushtet e shpërndarjes, sasinë e mallit, vlerën e mallit, shtetin tranzit / transship, dhe vendin e origjinës së mallit	Subjekti i huaj / Aplikanti	Po
	4	Kërkesë për certifikatë, e plotësuar sipas formularit tip, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular, firmosur nga përfaqësuesi ligjor i subjektit (kopje e pasaportës / kartës së identitetit)	Aplikanti	Po
	5	Kopje të faturës së mallit (proforma invoice), të nënshkruar nga një përfaqësues i shoqërisë	Aplikanti	Po
	6	Kopje e noterizuar e kontratës apo urdhërporosisë	Aplikanti / Noteri	Po
	7	Mandatpagesa e tarifës përkatëse	Bankë	Po
	8	Dokumente të tjera të vlefshme që do të konsiderohen si të tilla nga AKSHE	Aplikanti	Po
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse Zyrat e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE)	Qyteti Tiranë	Adresa Blloku i Ambasadave, Rruga "Skëndërbeg", Pallati IV, Kati 5, Tiranë	Orari E hënë - e enjte, ora 08:00 - 16:30 E premte, ora 08:00 - 14:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1 Ofrohet informacion mbi shërbimin	Niveli 2 Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Niveli 3 Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Niveli 4 Shërbimi ofrohet tërësisht online
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë 100 lekë	Tarifa shtesë Komisioni bankar	Tarifa Online Nuk ka	Mënyra e pagesës Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	10 ditë pune			
10. Çfarë përfitoj?	Certifikatë ndërkombëtare importi për mallra ushtarake			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	6 muaj			
12. Ku e marr?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input checked="" type="checkbox"/>	E-albania <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE)			Kontaktat në:
				Orari

14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	<i>E- albania: e-albania.al</i> <i>ADISA web: www.adisa.gov.al</i> <i>ADISA email: Informacion@adisa.gov.al</i> <i>AKSHE web: akshe.gov.al</i> <i>Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118</i>	<i>Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike:</i> <i>E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00</i>
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	<i>Në sportele</i> <input checked="" type="checkbox"/> <i>Me postë</i> <input checked="" type="checkbox"/> <i>Web-i i Institucionit</i> <input type="checkbox"/> <i>me e-mail</i> <input type="checkbox"/> <i>Në platformën "Shqipëria që duam"</i> <input checked="" type="checkbox"/> <i>Link: www.shqiperiaqeduam.al</i>	
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	<i>*Ligji Nr. 46, datë 23.07.2018, "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij</i>	